

VENDIM
Nr.112, datë 21.2.2007

PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, shkronjat “ç”, “d” e “e”, dhe 7 shkronja “a”, të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë me vlerë, për vitin 2007, prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh.

2. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë u jep ndihmë, në formë subvencioni të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, deri në 1 000 000 (një milion) lekë, por në asnjë rast më shumë se 50 për qind të vlerës së kostove të pranueshme. Kostot e pranueshme, që mund të bashkëfinancohen, përfshijnë kostot për:

a) investime, të prekshme dhe të paprekshme, në formën e përmirësimeve teknologjike, për përshtatje produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të cilësisë;

b) shërbime këshillimore, në formën e studimeve të tregut dhe të trajnimeve;

c) pjesëmarrje, për herë të parë, në një panair ose ekspozitë jashtë shtetit, si vizitor apo ekspozues.

3. Përfitojnë nga Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) prodhojnë produkte ose ofrojnë shërbime, që tregtohen apo që mund të tregtohen në nivel ndërkombëtar dhe që, gjatë procesit, i japin një vlerë të shtuar, të konsiderueshme produktit përfundimtar;

b) kanë një strategji dhe plan marketingu për zgjerimin e ekspertëve;

c) janë në gjendje të financojnë 100 për qind të gjitha kostot e projektit, të propozuara para përfundimit të tij.

4. Pagesa e subvencionit të bëhet në fund të projektit, kundrejt faturës së shpenzimeve të kryera.

5. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë fillon të zbatohet në vitin 2007 dhe zgjat për një periudhë 3-vjeçare.

6. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve (ALBINVEST) për menaxhimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë.

Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, e cila miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila do të krijojë një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të ALBINVEST-it.

8. Për vitin 2007, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kalojë për institucionin e varësisë, ALBINVEST, shumën 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, në nënzërin “Fondi i konkurrueshmërisë”, i cili zëvendëson nënzërin “Studime në fushën e investimeve” të zërit “Mbështetje për zhvillim ekonomik”.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha